

Q.B.T.B-VLORË

PROGRAM –PUNE

“Ditë fushe” me temë:”Krasitja dhe mirëmbajtja e kurorës së ullirit”

Ky aktivitet do të zhvillohet në ambjentet e Q.T.T.B-së në parcelën e ullinjëve me moshë 50 vjecare në bazën eksperimentale të Shamogjinit.

Ullishtja gjatë viteve të fundit i është nënshtruar ndërhyrjeve të përvitëshme në dy drejtime

- a) për marjen e copave për shtim në serën e nebulizimit për kultivarin Kalinjot dhe
- b) për sigurimin e prodhimit të përvitshëm në kultivarin Frantojo.

Për të dy këto aspekte bimëve me anë të krasitjes u është dhënë forma e mbajtjes duke e shoqëruar me teknologjinë e mirëmbajtjes që realizohet cdo vit.

Për realizimin e aktivitetit të mësipër në këtë parcelë për qëllim demonstrativ do të caktohen disa kategori bimësh që do të tregohet për krasitjen prodhuese, krasitjen riformuese dhe krasitjen ripërtëritëse.

Nga ana e sektorit të bazës së Shamogjinit duhet të sigurohet inventari i bazës materiale që shërbejnë për kryerjen e krasitjes si :

1-motosharë, gëshëre krasitse të tipeve të ndryshme të shkurtëra të gjata dhe për përdorim në lartësi, shkallë të madhësive të ndryshme, preparate për dizifektimin e plagëve të krijuara gjatë prerjeve dhe të veglave të punës.

Me puntore të specializuar do të krijohen tre grupe pune me nga dy punëtore të cilët do të kryejnë krasitje -prodhuese, krasitje riformuese dhe krasitje ripërtëritëse.Për këtë veprimtari do të caktohen tre bimë të ndryshme që kanë nevojë për ndërhyrje të tilla.

Pas përfundimit të kryerjes së krasitjes gjithë pjesëmarrësit do të shikojnë bimët dhe do të bëjnë vrejtime .

Në fund do të bëhen konkluzionet mbi rezultatet e aktivitetit si dhe do të shpërndahet një material i shkruar i shoqëruar me një fletëpalosje

Materiali i shkruar dhe fletëpalosja duhet të jenë pregatitur deri në dt 15.02.2013(Z.V, R.M)

Shumëfishimi i tij dhe pregatitja e dosejeve që do të shpërndahen do të realizohet nga (I.F, A.LL) në aktivitetin e ditë fushës do te marin pjese specialistë dhe fermer potencial nga prefektura e Vlorës, Fierit, Beratit Tirane dhe Elbasan etj

Aktiviteti do të zhvillohet më 22.02. 2013 ora 10 në Q.T.T.B-Vlorë

Realizimi i këtij aktiviteti duhet të mbështetet me një buxhet prej 10.000 lekë i detajuar si më poshtë

1-Blerje dhe pregatitja e dosjeve me materialet për 30 persona	3000 lekë
2-Kafe dhe ujë	për 30 persona 3000 lekë
3-Fotografi stampim etj	4000 lekë
4 Shuma	10000 lekë

Specilist i Sektorit te Teknologjive Bujqesore.

Dr .Zaim Veshaj